



**VENDIM**

**Nr. 79 Datë 24.08.2011**

**PËR  
FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË  
SHOQËRISË “SELCA ENERGY“ SHPK, PËR LËNIE PENG SI  
KOLATERAL TË HEC/SELCA**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9072 date 22.05.2003 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar, neni 20, pika 1, të “Rregullores së procedurave të transferimit të asetëve të të licensuarve“ miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr.89, datë 13.12.2006, neni 8, si dhe pikës 1.3 dhe 1.6 të *Licensës me Seri PV10P për Prodhimin e Energjisë Elektrike*, nenit 18, pika 1, germa “a”, të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.21, date 18.03.2009, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 24.08.2011, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “SELCA ENERGJI” sh.p.k, si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për lënien peng të asetit të Hec – “Selca” si kolateral pranë Bankes Credins,

**Konstatoi se:**

Aplikimi i shoqërisë “SELCA ENERGJI” sh.p.k plotëson kërkesat e parashikura nga ERE në Rregulloren e procedurave të transferimit të asetëve të të licensuarve”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr. 89, date 13.12.2006 si me poshtë:

**Neni 7, pika 1.1 dhe 1.2**

Është paraqitur në mënyrë të plotë dhe korekte.

**Neni 7, pika 1.3, germa a, b, c, d, e, f, g, h,**

Është paraqitur në mënyrë të plotë dhe korekte.

**Neni 7, pika 2, 3, 4 dhe 5**

Është plotësuar tërësisht.

Për gjithë sa më sipër cituar Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

**Vendosi:**

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “SELCA ENERGY“ sh.p.k, për lënie peng si kolateral të Hec/Selca pranë Bankes Credins.
2. Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut do të njoftojë aplikuesin lidhur me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.